



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 40 , datë 11. 05. 2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLOREVE “PËR MARRËDHËNIET E KËSHILLIT BASHKIAK ME PUBLIKUN DHE MEDIAN” DHE “SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I PETICIONEVE DHE INICIATIVAVE QYTETARE”, SI EDHE TË KODIT “KODI I SJELLJES DHE I PARANDALIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESAVE TË KËSHILLTARIT BASHKIAK”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me dt. 11 .05 .2020 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Bashkia, me shkresë Nr.2319.Prot datë. 09.05.2020 Për miratimin e Rregulloreve “Për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median” dhe “Shqyrtimi dhe miratimi i peticioneve dhe iniciativave qytetare” , si dhe tw kodit “Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të Këshilltarit Bashkiak”
Në mbështetje të nenit 54 gërma “a” nenit 55 pika 3 të Ligjit Nr.139/2015, datë . 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “. Duke ju referuar Projekt- Drafteve model, të hartuara nga projekti BtF (Bashki të Forta) “Për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median”, “Shqyrtimi dhe miratimi i peticioneve dhe iniciativave qytetare” si dhe të kodit “ Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të Këshilltarit Bashkiak” të rekomanduara për miratim nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Komisioni i Këshillit Bashkiak, Juridike Rend Konflikte pasi mori në shqyrtim këto modele, i propozon për miratim draftin final me disa ndryshime dhe rregullime duke e përshtatur me funksionet e Këshillit Bashkiak Rogozhinë. Me propozim tw Komisionit për çështjet Juridike , Rend , Konflikte , Këshilli Bashkiak,

VENDOSI :

1. Miratimin e Rregullores “Për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median” sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Miratimin e Rregullores “Shqyrtimi dhe miratimi i peticioneve dhe iniciativave qytetare” sipas lidhjes bashkëngjitur.
3. Miratimin e Kodit “Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të Këshilltarit Bashkiak” sipas lidhjes bashkëngjitur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

4. Të dyja këto Rregullore dhe Kodi i lartëshënuar , theksojmë se janë pjesë përbërëse e Rregullores bazë “Për organizmin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë” të miratuar me VKB-në Nr .7, datë 27.01.2020.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Këshilli Bashkiak Rrogozhinë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “ dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARË E KËSHILLIT
MUKA MËS GIXHARI

